

# VIT I HUMBUR

Zbatimi i MSA-së në vitin 2019

# VIT I HUMBUR

Zbatimi i MSA-së në vitin 2019

Mars 2020, Prishtinë

**Titulli i publikimit:**

Vit i humbur: Zbatimi i MSA-së në vitin 2019

**Publikuar nga:**

Instituti i Kosovës për Politikat Evropiane

**Vendi dhe koha e publikimit:**

Prishtinë, mars 2020

(faqe qëllimisht lënë zbrazët)

# HYRJA

---

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) hyri në fuqi më 1 prill 2016. Këtë vit Kosova shënon përvjetorin e katërt të hyrjes në fuqi të MSA-së.

Kosova ka marr për detyrim që të zbatoj dispozitat e MSA-së brenda periudhës dhjetë vjeçare. Me qëllim zbatimit të obligimeve që burojnë nga MSA, Kosova miraton çdo vjet Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA). Kërkesa për hartimin e Programit buron nga neni 74, pika 3 e MSA-së. Dokument të tillë, nën emërtime të ndryshme, e kanë në fuqi të gjitha vendet e rajonit që janë pjesë e procesit të Stabilizim Asociimit, psh. në Shqipëri: Plani Kombëtar për Integrim Evropian, në Serbi: Programi Kombëtar për Adoptimin e Acquis apo në Mal të Zi: Programi Kombëtar për Anëtarësim në BE.

Programi përmban masa konkrete të cilat propozohen nga vet institucionet e shtetit për të adresuar dispozitat e veçanta të MSA-së.

Në këtë kontekst, duke marr për bazë raportet vjetore për zbatimin e MSA-së, mund të konkludojmë se që nga hyrja në fuqi e MSA-së në Kosovë mungon vullneti politik për të ndërmarr reformat e parapara me Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Në bazë të statistikave të vetë institucioneve:

- Në vitin 2016, programi kishte 1,347 masa – nga të cilat institucionet arritën të përmbushin 741 masa, apo 55% të programit.
- Në vitin 2017, programi kishte 967 masa – nga të cilat institucionet arritën të përmbushin 600 masa, apo 62% të programit.
- Në vitin 2018, programi kishte 532 masa – nga të cilat institucionet arritën të përmbushin 362 masa, apo 68% të programit.
- Në vitin 2019, programi kishte 401 masa – nga të cilat institucionet arritën të përmbushin 204 masa, apo 51% të programit.

Në këtë drejtim, përkundër zvogëlimit të vazhdueshëm të numrit të masave në kuadër të programit, në vitin 2019 shkalla e zbatimit ka arritur nivelin më të ulët çysh nga hyrja në fuqi e MSA-së në vitin 2016.

Sa i përket llojit të masave në vitin 2019 nga gjithsej 401 masa të parapara, programi përmbante 160 masa legislative dhe 241 masa implementuese.

Shkalla më e ulët e zbatimit vërehet tek masat legislative, me ç'rast shkalla e zbatimit të masave legislative gjatë vitit 2019 është 36.88%, pasi që 59 nga 160 masa të planifikuara janë zbatuar. Ndërsa, gjendja është pak më pozitive tek masat implementuese, pasi që shkalla e zbatimit të masave implementuese gjatë vitit 2019 është 60.17%, pasi që 145 nga 241 masa të planifikuara janë zbatuar.


Disa nga masat dhe reformat e pa zbatuara janë:

- Miratimi i dy projektligjeve: për racionalizimin e agjencive dhe institucioneve të pavarura; dhe për kontestet administrative;
- Miratimi i katër (4) projektligjeve në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore;
- Miratimi i pesë (5) projektligjeve në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë;
- Miratimi i pesë (5) projektligjeve në fushën e mjedisit;
- Rritja e numrit të inspektorëve të punës;
- Miratimi i tri (3) rregulloreve në fushën e politikave të konkurrencës: de minimis për ndihmë shtetërore; për ndihmë rajonale; dhe për ndihmë horizontale;
- Miratimi i strategjisë për digjitalizim të transmetimit tokësor;
- Miratimi i tri (3) rregulloreve në fushën e sigurisë së ushqimit;
- Funksionalizimi i fabrikës për përpunimin e mbetjeve të kafshëve.

Sa i përket vitit 2020, bëjmë thirrje institucioneve që të tregojnë vullnet të shtuar politik për të zbatuar reformat e parapara me MSA. Viti 2021 do të shënon pesë vite nga hyrja në fuqi e MSA-së dhe ky do jetë moment i rëndësishëm, pasi që në përputhje me nenin 9 të MSA-së, Këshilli i Stabilizim Asocimit do të bënë vlerësimin detaj të zbatimit të MSA-së dhe rrjedhimisht do të merr masat për të ardhmen e procesit Stabilizim Asocimi për Kosovën.


# NUMRI I MASAVE TË PKZMSA-SË

2016 - 2019



# NUMRI I MASAVE TË ZBATUARA TË PKZMSA-SË


2016 - 2019






# NIVELI I ZBATIMIT TË PKZMSA-SË

2016 - 2019




# ZBATIMI I PKZMSA-SË

2019




# ZBATIMI I MASAVE LEGJISLATIVE

2019



# ZBATIMI I MASAVE IMPLEMENTUESE

2019



(faqe qëllimisht lënë zbrazët)

